REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery	10 . 12	201 8	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7520/2018		113

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

A.nr.745/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani - kryetar, Shkëmb Manaj dhe Malsore Gashi- anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 745 /2018, të datës 16.11.2018, së ankuesit Nexhat Krasniqi, me adresë banimi, rruga „ Rexhep Luci " nr. 19/9 , nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike " Ndërprerje e marrëdhënies se Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.12.2018, mori këtë

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa A. Nr. 745/2018 e datës 16.11.2018 e parashtruar nga ankuesi Nexhat Krasniqi.

A r s y e t i m

Ushtruesi i Detyrës se Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me datën 12.11.2018, me numër protokolli 10641, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit Nexhat Krasniqi, i ka shqiptuar masën disiplinore „ Ndërprerje e marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil".

Ankuesi Nexhat Krasniqi, i pakënaqur me vendimin e datës 12.11.2018, së ushtruesit të detyrës se Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me datën 16.11.2018, me numër protokolli 6878/2018, sipas këshillës juridike që i është dhënë në vendim, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 745/2018, me numër protokolli 6878/2018 , drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimi i datës 12.11.2018, i u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë se Infrastrukturës; Vendimi i datës 09.07.2018 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë se Infrastrukturës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e Këshillit e datës 19.11.2018 me numër prot. SKPMSHCK 69033/2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se edhe përkundër faktit që Këshilli i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës kërkesën për përgjigje në ankesë të e datës 19.11.2018 me numër prot. SKPMSHCK 69033/2018, e njëjta nuk i është përgjigjur kërkesës së Këshillit duke vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/l -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se ***"Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin".***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Nexhat Krasniqi, **është e palejuar,** ***sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ushtruesi i detyrës se Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me datën 12.11.2018, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit Nexhat Krasniqi, i ka shqiptuar masën disiplinore „ Ndërprerje e marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil", duke i dhënë këshillën juridike që në afat prej 30 ditësh nga marrja e këtij vendimi ka të drejtë të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin ankesave, ka konstatuar se ankuesi Nexhat Krasniqi, e ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pa i shterrur burimet e brendshme të animimit, respektivisht pa parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek organi i punësimit - Ministria e Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin ankesave ka konstatuar se ankuesi Nexhat Krasniqi, ankesën me datën 16.11.2018, me numër protokolli 6878/201, në Këshill, e ka parashtruar në kundërshtim me ne nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/l -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se ***"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe",*** si dhe në kundërshtim me nenin nenin 82 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se ***"Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës".***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ushtruesi i detyrës se Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me datën 12.11.2018, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit Nexhat Krasniqi, i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndërprerje e marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil", duke i dhënë këshillën juridike që në afat prej 30 ditësh nga marrja e këtij vendimi ka të drejtë të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. në këtë rast kolegji konstaton se ankuesit i është dhënë gabimisht këshilla juridike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 82 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/l -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sepse në këtë rast ankuesit është dashur ti jepet këshilla juridike që ka të drejtë ankese në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në pajtim me ligjin ankuesi ka të drejtë të parashtroj ankesë fillimisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të organit të punësimit dhe pastaj nëse është i pakënaqur me vendimin e Komisonit, mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 503/2018

Eshref SHABANI	***Rushit KAJTAZI***
Kryetar i Kolegjit	***Procesmbajtës***

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit* Nexhat Krasniqi;
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë se Infrastrukturës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturë; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*